

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryetar i kolegjit, Shqipe Qerimi dhe Hashim Çollaku, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Ilmije Zeka, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit H.F., nga Skenderaj, për shkak të pesë veprave penale të mashtrimit nga neni 261 par. 2 lidhur me par 1 të Kodit të Penal të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit H.F., av. F.G.-B. të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.3430/2015 të datës 22.02.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), më 03.10.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e ankesës së mbrojtëses të akuzuarit H.F., av. F.G.-B., **ndryshohet** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.3430/2015, datë 22.02.2016, vetëm përkitazi me vendimin për dënim, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarin H.F. për veprën penale Mashtrimi në vazhdim, nga neni 261 par.2 lidhur me par 1 të KPK-ës e për të cilën është shpallur fajtor i shqipton dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, e të cilin dënim do ta vuaj pasë plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i ankimuar në pjesët tjera ngel i paprekur.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin P.nr.3430/2015 të datës 22.02.2016, të akuzuarin H.F. e ka shpallur fajtorë për veprën penale të Mashtrimit nga neni 261 par.2 lidhur me par 1 të KPK-së dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite të cilin dënim ka për ta mbajtur pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. I akuzuari është detyruar që të dëmtuarit R.Z. ti kompensojë dëmin e shkaktuar në vlerë të precizuar 18.391.5 € (tetëmbëdhjetë mijë e treqind e nën dhjetë e një gjysmë euro) dhe të dëmtuarit Sh.S. t'ja kompensojë dëmin në vlerë prej 8.698 € (tetë mijë e gjashtëqind e nën dhjetë e tete euro) ku për tre muaj nga çmimi i qirasë mujore që ishte 2250 € që ishte gjithsejtë 6.750 € plus shpenzimet komunale që arrijnë shumën prej 1.940 € e që gjithsejtë arrijnë shumën prej 8.698 € atë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kërcënim të përmbarrimit. I akuzuari është obliguar që të kompensoi shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguajë 100 € në afat prej 15

ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Të dëmtuarit R.C. dhe S.L. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontestin e rregullt juridiko- civil nga i dëmtuari R.J. kërkesë pasurore juridike nuk pati.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur mbrojtësja e të akuzuarit H.F., av. F.G.-B. , për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabueshëm apo jo të plot të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë të akuzuarin H.F. ta lirojë nga akuza apo çështja të kthehet në rigjykim apo të akuzuarit ti shqiptohet një dënim me i butë .

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.677/2016, datë 24.05.2016, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit H.F., av. F.G.-B., të refuzohet si e pa bazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit konform dispozitave të nenit 390 të KPPK-së, mbajti seancën e kolegjit për të cilën i njoftoj palët, në të cilën seancë nuk prezantoi askush edhe pse ishin të ftuar me rregull.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

-Ankesa e mbrojtëses se të akuzuarit H.F., av. F.G.-B., përkitazi me vendimin mbi dënimin është e bazuar.

Në ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit pretendohet se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale kjo sepse nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 të KPPK-së sepse aktgjykimi nuk është i bazuar, është i pakuptueshëm dhe ka kundërtënie në brendësinë dhe arsyetimin e tij, pra aktgjykimi dënues në dispozitivin e tij duhet të ketë të shënuar së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale edhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dëmtuarve, qysh në kontaktin e parë i njëjti i ka deklaruar atyre se kush ishte ai, se kënd e përfaqësonte ku çdo here e prezantonte dokumentacionin e subjektit të IPD-së krejtësisht i themeluar në baza ligjore dhe se i njëjti vepronte si subjekt juridik i autorizuar nga organizata e lartcekur dhe gjithnjë deklaronte se nuk kishte para në dorë dhe se vlerën e mallit do ta paguante pas një kohe e atë pasi të realizohet pagesa nga Drejtori ekzekutiv i IPD-së Xh.B. i cili nuk jetonte në Kosovë por jetonte dhe punonte në Amerikë dhe se nga i njëjti i pret mjetet financiare, pra këtë kontratë ai e nënshkruante në mënyre të lirë, pa presion dhe me vullnet të dyanshëm duke ofruar të dhënat e sakta dhe të plota sa i përket subjektit që përfaqësonte si dhe të dhënat personale dhe vendqëndrimin e organizatës në fjalë, me pas i ka siguruar se ishte debitor kundrejt tyre dhe se në të ardhmen e afër do të bëjë përpjekjet për të ekzekutuar detyrimin kundrejt kreditorëve. Mbrojtësja në ankesë thekson se Gjykata e shkallës së parë pretendon ta arsyetoj aktgjykimin e ankimuar duke cituar se IPD-ja udhëhiqej nga drejtori dhe bordi dhe se

në cilësinë e menaxherit të merrte veprime në interes të IPD-së e jo në interes të tij, ky konstatim sipas mbrojtëses është kundërthënës sepse malli ka përfunduar i tëri në zyrën e marrë me qira me adresë të njohur me seli në Prishtinë rr.” Zija Shemsiu” nr 25, me firmë të emërtuar IPD dhe nuk ka përfunduar asgjë në shtëpinë e tij dhe në xhepat e tij personal.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e mësipërme ankimore sa i përket veprës penale si në aktgjykimin e ankimuar nuk qëndrojnë e as që ka shkelje tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kjo gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. Kështu aktgjykimi i ankimuar pra edhe dispozitivi është qartë, i kuptueshëm dhe konkret, nuk përmban kundërthënje me vet vetën, ose me arsyet e paraqitura në të. Përshkrimi i dhënë në dispozitiv përmban të gjitha arsyet dhe faktet relevante të cilat janë dhënë në mënyrë koncize kështu që në asnjë mënyrë nuk paraqitet si kundërthënës dhe dubioz. Aktgjykimi i ankimuar përmban arsye të duhura dhe faktike dhe juridike mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje juridiko- penale e të cilat si të drejtë dhe të ligjshme i mbështet edhe kjo gjykatë, sepse kanë mbështetje në provat e administruara. Ajo ka bërë vlerësimin dhe analizën e të gjitha provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta e të cilat si të drejta i aprovon edhe kjo Gjykatë. Kjo Gjykatë po ashtu vlerëson se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje tjera esenciale të cilat kjo gjykatë sipas dispozitës së nenit 394 të KPP i shqyrton çdo herë detyrimisht. Në arsyetim janë përshkruar në mënyrë të qartë elementet inkriminuese të të akuzuarit që përbëjnë veprën penale në vazhdim për të cilën i akuzuari është shpallur fajtorë, pra mënyra se si i akuzuari ka kryer veprimet inkriminuese me datë, vend dhe kohë si në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar, veprime këto që përmbajnë elementet qenësore të veprës penale për të cilën i njëjti me të drejtë është shpallur penalisht përgjegjës dhe fajtor. Në këtë drejtim aktgjykimi përmban edhe arsye të qarta dhe është bazuar në fakte dhe prova të mjaftueshme përkitazi me fajësinë e të akuzuarit. Konkludimi i Gjykatës së shkallës së parë se parë se në veprimet e të akuzuarit H.F. qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar është i bazuar. Se të dëmtuarit R.Z. , R.C. , S.L. dhe Sh.S. janë vënë në lajthim duke i shtyrë të njëjtit të veprojnë në dëm të pasurisë së tyre , se i akuzuari nëpërmjet paraqitjes së rreme të fakteve është prezantuar rrejshëm si menaxher në organizatën Instituti për progres demokratik i shtynë të dëmtuarit e lartcekur të veprojnë në dëm të pasurisë së tyre, kurse borxhin nuk i’ ua kthen të dëmtuarve dhe pse të njëjtëve iu kishte premtuar se borxhin do ua paguaj dhe se të njëjtëve iu shkakton dëm si në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar. Një gjendje e tillë faktike nga gjykat e shkallës së parë vërtetohet nga dëshmia e të dëmtuarit R.Z. , dëshmia e dëshmitarit N.Z., provave materiale si dhe foto dokumentacionit të shkresave të lëndës si dhe pjesërisht nga mbrojtja e të akuzuarit.

Mbrojtësja pretendon se e meta kryesore e këtij vendimi gjyqësor është se ka mungesa të theksuara të provave dhe fakteve ngase në të ka vetëm supozime, paragjykime dhe deklarata të cilat janë marrë në mënyrë selektive të të dëmtuarve, dhe në provat e administruara mungon vlerësimi i tyre një nga një duke mos i ndërlidhur këto prova

reciprokisht njëra me tjetrën në kuptim të dispozitës së nenit 361 par.1 dhe par 2 të KPK-së, nuk arrin të konstatohet gjendja faktike si pretendohen në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe gjithashtu në këtë diapozitiv të aktgjykimit nuk janë konkretizuar qartë shumat materiale se sa janë marrë nga ana e debitorit sa janë kthyer nga to, dhe sa është borxhi i mbetur.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, pretendimet e mësipërme ankimore nuk janë të bazuara dhe nuk e venë në dyshim gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe në të në mënyrë të qartë janë të përshkruara veprimet inkriminuese të të akuzuarit për të cilat është shpallur fajtorë, në fakt gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar ka vënë arsye të mjaftueshme për të gjitha provat e administruara, duke arsyetuar se cilat i merr si të vërtetuara, i ka arsyetuar të gjitha pikat e aktgjykimit, i ka vlerësuar të gjitha provat administruara duke i përfshirë edhe deklaratën e të akuzuarit e cila ka qenë objekt i vlerësimit, ajo është vlerësuar si çdo provë tjetër me pajtim me dispozitat ligjore, me ç rast në mënyrë të çartë është arsyetuar përse nuk është aprovuar mbrojtja e tij, ka përshkruar gjendjen faktike të cilën e ka vërtetuar dhe ka vënë arsye të çarta dhe bindëse për vërtetimin e tillë të fakteve.

Në këtë çështje juridiko-penale sipas shkresave të lëndës del se i akuzuari me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete dhe për ti shkaktuar dëm material personit tjetër, i akuzuari e ka mashtruar të dëmtuarit R.Z. , pronar i ndërmarrjes Info -tech , R.I. pronar i Libraris "NN", R.C. , pronar i firmës "NN" , S.L. përfaqësues i salonit të mobileve "NN" dhe Sh.S. pronar i shtëpisë që gjendet në rr."...." nr. ...në Prishtinë e të cilët janë vënë në lajthim duke e shtyrë të njëjtit të vepronjë në dëm të pasurisë së tyre , dhe se i akuzuari nëpërmjet paraqitjes së rreme të fakteve, është prezantuar rrejshëm si menaxher në organizatën Instituti për progres demokratik dhe se i njëjti lidhë dhe nënshkruan kontrata në emër të Xh.B. dhe nga i dëmtuari R.Z. merre mjete dhe atë 23 llap top, 13 printer në vlerë të përgjithshme prej 18.391,5 euro dhe se të njëjtat mjete iu shet personave të tjerë kurse borxhin nuk ia kthen të dëmtuarit dhe pse të nijetit i kishte premtuar se borxhin do ua paguaj përmes llogaris me çrast të dëmtuarit si pronar i ndërmarrjes Info -tech i shkaktonte dëm në vlerë të përgjithshme prej 18.391,5 euro, pastaj nga i dëmtuari R.I. merre material harxhues në librari në vlerë të përgjithshme prej 750 euro dhe se këto para nuk ia paguan të dëmtuarit , pastaj nga i dëmtuari R.C. në emër të marrëveshjes për reklamim të bëj shërbime reklamuese i shkaktonte dëm në shumë prej 5.305,00 euro dhe se për këto shërbime reklamuese që i dëmtuari i bën të akuzuarit parat nuk ia paguan, pastaj dëmtuarit S.L. nga ndërmarrja e tij i merre inventar në vlerë prej 856 euro për ndërmarrjen e tij dhe i akuzuari parat nuk ia paguan të dëmtuarit , po ashtu të dëmtuarit Sh.S. për shtëpinë e marrë me qira për tre muaj qiranë në vlerë prej 2250 euro nuk ia paguan të dëmtuarit . Një gjendje e tillë faktike vërtetohet nga dëshmia e të dëmtuarve R.Z. , N.Z., R.Z. , R.C. , S.L. dhe Sh.S., provave materiale si dhe foto dokumentacionit të shkresave të lëndës si dhe pjesërisht nga mbrojtja e të akuzuarit.

Nga të gjitha këto prova me pa dyshim vërtetohet se i akuzuari i ka mashtruar të dëmtuarit e lartcekur , duke i vene në lajthim të njëjtit në këtë mënyrë i ka shtyrë të njëjtit që të vepronjë në dëm të pasurisë së tyre, i akuzuari ka përfituar kundërligjshëm nga të dëmtuarit , andaj, edhe konkludimi i gjykatës së shkallës së parë se në veprimet e të akuzuarit janë plotësuar të gjitha elementet e veprës penale për të cilat akuzohet është i drejtë dhe si të tillë e aprovon edhe kjo gjykatë.

Gjykata e shkallës së parë me të drejtë mbrojtjen e të akuzuarit dhe në shqyrtim gjyqësorë e ka vlerësuar si të pabazuar dhe të orientuar me qëllim të ikjes apo zvogëlimit të përgjegjësisë penale, dhe kjo gjykatë një vlerësim të tillë e aprovoi si të bazuar.

Gjithashtu mbrojtësja e të akuzuarit pretendon se Gjykata e shkallës së parë është përfshirë në shkelje të ligjit penal nga neni 385 par.1 pika 1.2 i KPK-së sepse lidhur me të akuzuarin H.F. ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë për veprën penale të Mashtrimit nga neni 261 par 2 lidhur me par.1 të KPK-së kjo sepse mbrojtja mendon se mosekzistimi i detyrimeve civile në afatin e caktuar, pa mohuar faktin e detyrimit nuk mund të përbejë elemente të veprës penale të mashtrimit, pra fakti i mos ekzekutimit të detyrimeve në kohe nuk mund të shërbejë si bazë për marrjen në përgjegjësi penale Mashtrimi pasi nuk kemi vepër penale të konsumuar, pra në rastin konkret mbrojtësja shton se është aplikuar gabimisht ligji penal në dëm të të mbrojturit të saj gjithashtu mbrojtësja shton se Gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pra gjendja faktike nuk mund të vërtetohet pasi mungon vlerësimi i drejtë në mungesë të provave të cilat janë marrë në mënyre të njëanshme dhe në mënyre selektive e të cilat nuk u janë nënshtruar vlerësimit kritik dhe si pasojë e kësaj, kemi një vlerësim të gjendjes faktike e cila nuk i përkon realitetit, pra gjykata nuk e ka marrë parasysh propozimin e përsëritur të të akuzuarit, që me qëllim të zbardhjes të gjendjes faktike të mirën në pyetje edhe pjesëtarët e organizatës IPD-së , ku me anë të kësaj kishte për tu vërtetuar në mënyrë të saktë dhe të drejtë veprimet e të akuzuarit të cilat nuk kanë qenë të orientuara ta dëmtojnë askënd.

Kjo gjykatë pretendimet e lartcekura të akuzuarit për shkelje të ligjit penale i vlerëson si të pabazuara, pra kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë me vërtetimin e drejt dhe të plot të gjendjes faktike drejt ka aplikuar edhe ligjin penal ndaj të akuzuarit. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qarta për elementet qenësore të kësaj vepre penale si për vënien në lajthim të personit të dëmtuar, veprimin e të dëmtuarve në dëm të pasurisë së tyre dhe për përfitimin e kundërligjshëm pasurorë të të akuzuarit , arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me këto elemente të veprës penale si të drejtë dhe të argumentuar i aprovoi edhe kjo gjykatë. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Gjykata e shkallës së parë gabimisht për secilën vepër penale nga dispozitivi i akuzës ka caktuar dënime veç e veç për secilën nga këto vepra penale (si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar) pasi që ka bërë ri cilësimin e këtyre veprave penale në një vepër penale në vazhdim për çka edhe ka dhënë arsyetimin e saj e që kjo gjykatë e aprovoj si të bazuar. Sipas dispozitës të nenit 81 të KPRK-së për veprën penale në vazhdim nga gjykata shqiptohet vetëm një dënim e jo siç ka vepruar gjykata e shkallës së parë kur për secilën nga këto vepra penale ka përcaktuar dënime të veçanta e me pas ka shqiptuar dënimin unik pa e emërtuar si dënim unik. Me aplikimin e drejtë të ligjit penal si në dispozitiv të këti aktgjykimi, konform dispozitës të nenit 81 të KPRK-së, është evitu edhe shkelja e ligjit penal në dëm të të akuzuarit.

Mbrojtësja ka bërë ankesë edhe për vendimin mbi dënimin ku thekson se nëse Gjykata e Apelit gjen ndonjë rrethanë e cila e rëndon të mbrojturin e saj, atëherë mbrojtja kërkon një dënim më të butë duke u bazuar në nenin 64 të KPK-së , dhe të merr parasysh rrethanat lehtësuese siç janë se i akuzuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, është familjarë, prind i dy fëmijëve, i gjendjes së rëndë ekonomike, dhe se i njëjti ka pasur sjellje korrekte

dhe të sinqerta si në hetuesi ashtu edhe gjatë gjithë procedurës gjyqësore andaj edhe me një dënim me të butë do të arrihej qëllimi i dënimit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e më sipërme ankimore të të mbrojtëses së të akuzuarit, janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë duke u mbështetur edhe në shkresat e lëndës i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, me ç'rast si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin ka marrë parasysh faktin se i akuzuari është familjar, se më parë nuk ka qenë i gjykuar, sjelljen korrekte gjatë gjithë procedurës, ndërsa si rrethanë rënduese ka marrë faktin se i akuzuari veprën penale e ka kryer duke ushtruar veprimtari e përfaqësuesit – menaxherit të organizatës IPD e regjistruar në mënyrë të rregullt, si rrethana rënduese mori edhe faktin se i akuzuari veprën penale e ka kryer me dashje direkte duke qenë plotësisht i vetdijshme për pasojat e veprimeve të tij dhe duke e dashur pasojën e krijuar nga motivi i përfitimit pasuror të kundërligjshëm, si rrethana rënduese mori edhe nivelin dhe intenzitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur me ligj e që në këtë rast ishte pasuria e personit tjetër – pasuria e të dëmtuarëve, një konstatim të këtillë të rrethanave relevante lehtësuese për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë, mirpo kjo gjykatë vlerëson se të njëjtat nuk janë vlerësuar në mënyrë meritore dhe të drejtë nga gjykata e shkallës së parë, e në mungesë të rrethanave posaçërisht rënduese dhe atyre rënduese pasi që sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk mund të trajtohet si rrethanë rënduese fakti se i akuzuari veprën penale e ka kryer duke ushtruar veprimtarinë e përfaqësuesit - menaxher të organizatës IPD e regjistruar në mënyrë të rregullt, faktin se i akuzuari veprën penale e ka kryer me dashje direkte duke qenë plotësisht i vetdijshme për pasojat e veprimeve të tij dhe duke e dashur pasojën e krijuar nga motivi i përfitimit pasuror të kundërligjshëm, si dhe nivelin dhe intenzitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur me ligj e që në këtë rast ishte pasuria e personit tjetër – pasuria e të dëmtuarëve, ngase të njëjtat janë elemente konstituive të kësaj vepre penale, andaj nga të lartëcekurat kjo gjykatë vlerëson se përgjegjësia penale e të akuzuarit është me e ulët se ajo që e ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë andaj të akuzuarit i shqiptojë dënim me të ulët me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe me intenzitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e posaçërisht duhet të jetë në funksion të preventives gjenerale dhe individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikojë në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprës penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 403 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.631/16, datë 03.10.2016

Bashk. profesionale,
Ilmije Zeka

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Anëtarët e kolegjit:

Shqipe Qerimi
Hashim Çollaku